

**FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT**

**NJOFTIMI PËR MODIFIKIMIN E MARRËVESHJES KUADËR/KONTRATËS GJATË  
ZBATIMIT**

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor

Emri                      Fondi Shqiptar i Zhvillimit  
Adresa Rruga “Sami Frashëri”, nr. 10, Tiranë  
Tel/Faks                +355 4 234885  
E-mail                  prokurimet@albaniandf.org  
Ueb-faqe                www.albaniandf.org

2. Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:

E-mail                  prokurimet@albaniandf.org.

3. Lloji i procedurës së prokurimit: Procedure e Hapur Marreveshje Kuader.
4. Lloji i kontratës /Marreveshjes kuader: Kontratë Publike Punë.
5. Numri i referencës së procedurës /Lotit: REF-30952-05-26-2022.
6. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “Ndërhyrje për përmirësimin e sigurise dhe sinjalistikës rrugore.”
7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): 45211350-7 Punë Ndërtimi.
8. Fondi limit/marreveshjes kuader: 166,665,673 lekë pa TVSH.
9. Situata sipas parashikimeve të nenit 127 të LPP dhe argumentet përkatëse për ta përdorur atë:  
Neni 127 të LPP pika 1/c ku parashikohet; “Kontrata publike apo marrëveshja kuadër mund të modifikohet pa zhvilluar një procedurë të re prokurimi në rastet e mëposhtme: c) kur modifikimi është bërë i nevojshëm për shkak të rrethanave të paparashikueshme nga autoriteti kontraktor dhe që nuk ndryshojnë në thelb natyrën e kontratës publike apo të marrëveshjes kuadër”.  
Modifikimi është bere i nevojshem per rrethanat e meposhtme:
  - Gjatë procesit të përzgjedhjes së projekteve e në vijim të thirrjeve të paraqitura nga bashkitë, është konstatuar se investimeve te kerkuara nga bashkite respektive ka kaluar parashikueshmerine e AK në momentin e hapjes së procedurës.
  - Me zbatimin e Marrëveshjes nëpërmjet minikontratave të lidhura aktualisht, është konstatuar një numer shumë i lartë i kërkesave të bashkive për këtë tipologji ndërhyrjesh, i cili dhe ka vijuar të rritet. Identifikimi i projekteve dhe thirrjeve nga bashkitë respektive ka qenë më tepër, duke e bërë te pamundur akomodimin e të gjitha kërkesave prioritare brenda kësaj marrëveshje.
  - Aktualisht FSHZH, në Programin Operacional dhe detajimin buxhetor 3 vjeçar nuk ka të riplanifikuar mbështetje logjistike të kësaj natyre, pra është e pamundur që në këtë moment të akomodohen dhe të përmbushen nevoja te paparashikuara prioritare të paraqitura nga bashkitë, nëpërmjet një procedure te re. Kjo, pavaresisht edhe arsytimit që, edhe nëse një procedure e re do të ishte e planifikuar dhe buxhetuar, do të kerkonte kohën e vet, konsideruar këtu afatet e kërkuara ligjore të procedurave të prokurimit për marrëveshjen kuadër, por edhe të minikonkurseve (shpallje, vleresime, ankesa,etj), të cilat do të ndikonin në zgjatje të procedurave për finalizimin e një marrëveshje tjetër kuadër për realizimin e projekteve sipas kerkesave të bashkive, dhe per rrjedhoje mos përmbushjen e nevojes së paraqitur si prioritare në këtë periudhe.
  - Me shkresë nr. 23917/153 prot., datë 12.02.2024 të MF është miratuar detajimi i buxhetit për shpenzimet kapitale sipas programeve respektive, ku dhe është përfshirë shtesa e buxhetit në masen 20%. Në këto kushte, duke konsideruar që në buxhetin maksimal të projektfishës që mbulon këtë objekt, është miratuar buxheti shtesë i lejuar nga Ministria e Financave, gjykohet që nevoja e projekteve të paparashikuara të mbulohet nëpërmjet modifikimit të vlerës shtesë të marreveshjes kuadër aktualisht në zbatim.
  - Vlen të theksohet po ashtu se modifikimi i kësaj marrëveshje nuk e ndryshon në thelb natyren e M.K, duke sqaruar se me zbatimin e projekteve shtese, kushtet jane te njëjta, nuk ndryshon në asnje moment objekti i kontratës, tipologjia është e njëjte duke iu përmbajtur kështu zërave të

dakordësuar në këtë marrëveshje. Modifikimi/shtesa e vlerës së marrëveshjes nënkupton shtesë në sasinë e zërave dhe jo rritje të vlerës për të njëjtin zë/sasi.

10. Përshkrimi i modifikimit të kontratës/Marrëveshjes Kuadër, përfshirë natyrën dhe sasinë ose vlerën e punimeve

Për shkak se:

- a. “Duke marrë në konsideratë kërkesat e bashkive nëpërmjet thirrjes së hapur nga FSHZH, lista e investimeve të kerkuara nga bashkive respektive ka kaluar parashikueshmerine e AK në momentin e hapjes së procedurës. Për të bërë të mundur realizimin e investimeve nga bashkitë, vlera aktuale e MK, nuk i mbulon punimet e paparashikuara, kërkohet modifikimi i vlerës shtesë të marrëveshjes në shumën 33,333,134 lekë pa tvsh, vlerë kjo që nuk e tejkalon 20% e MK.”
- b. Me shkresë nr. 23917/153 Prot., datë 12.02.2024 të Ministrisë së Financave është miratuar detajimi i buxhetit për shpenzimet kapitale sipas programeve.

Bazuar në:

- a) Nenin 127 të LPP pika 1/c ku parashikohet; “Kontrata publike apo marrëveshja kuadër mund të modifikohet pa zhvilluar një procedurë të re prokurimi në rastet e mëposhtme: c) kur modifikimi është bërë i nevojshëm për shkak të rrethanave të paparashikueshme nga autoriteti kontraktor dhe që nuk ndryshojnë në thelb natyrën e kontratës publike apo të marrëveshjes kuadër”.
- b) Faktin që vlera monetare e modifikimit, nuk e tejkalon 20% të vlerës së marrëveshjes dhe nuk e ndryshon në thelb natyrën e saj.
- c) Kërkesën dhe relacionin për amendim të Marrëveshjes Kuadër të miratuar nga Drejtoria e Menaxhimit të Programeve, modifikohet vlera totale me vlerën shtesë 33,333,134 lekë pa TVSH.

11. Vlera totale e kontratës së nënshkruar/marrëveshjes kuadër: 166,665,673 lekë, pa TVSH

12. Vlera e ndryshuar (nëse është rasti): 199,998,807 lekë pa TVSH

13. Kohëzgjatja e kontratës / Marrëveshjes Kuadër: 24 muaj

Dhe afati i ri (nëse është rasti): \_\_\_\_\_

14. Emri dhe adresa e operatorit/ëve Ekonomik:

OE “I.D.K - KONSTRUKSION” shpk, NUIS K51408016J, me adresë: Autostrada Tiranë-Durrës, Km.12, Rruga Zaja, Kodër Bërxullë, Vorë, Tiranë.

15. Data e nënshkrimit të modifikimit: 10/06/2024

16. Burimi i financimit: Buxheti Shtetit.

17. Informacion tjetër që vlerësohet i nevojshëm nga autoriteti/enti kontraktor: \_\_\_\_\_